



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Kryesia e Kuvendit

P-050

Prishtinë, më 14 dhjetor 2015, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C -301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 14 DHJETOR 2015

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Aida Dërguti, Slobodan Petroviq dhe Duda Balje, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Slavko Simiq dhe Mzfera Shinik.

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Blerim Latifi, Driton Lajçi dhe Avni Bytyçi.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi dhe Musli Krasniqi.

Nga Zyra e BE-së në Kosovë: Blerta Bejtullahu,
Nga OSBE-ja: Floiana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Kadri VESELI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari i njoftoi të pranishmit se këtë mbledhje e ka thirrur për shkak të rrethanave të krijuara nga veprimet e opozitës, përkatësisht hedhjes së gazit lotsjellës dhe bllokimit të seancës së sotme të Kuvendit.

Kryetari kërkoi mendimin e të pranishmëve se cilat veprime duhet ndërmarrë për tejkalimin e situatës së krijuar, me qëllim të krijimit të kushteve për mbajtjen e seancës plenare.

Lidhur me tejkalimin e situatës së krijuar dhe mbajtjen e seancës plenare diskutuan: Adem Grabovci, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Aida Dërguti, Ismet Beqiri, Slavko Simiq, Myfera Shinik, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryetari dha një pauzë për konsultime shtesë lidhur me mbarëvajtjen e punimeve të seancës plenare.

* * *

Pas pauzës, Kryesia e Kuvendit vendosi që seanca plenare t'i vazhdojë punimet në orën 13:00, në sallën alternative të Kuvendit, kati IV, dhe nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës: Glauk Konjufca, Shqipe Pantina, Salih Salihu, Mytaher Haskuka, Besnik Bislimi, Visar Ymeri, Aida Dërguti, Rexhep Selimi, Ramush Haradinaj, Pal Lekaj, Teuta Haxhiu, Daut Haradinaj, Bali Muharremaj, Lahi Brahimaj, Fatmir Limaj, Enver Hoti dhe Zafir Berisha, për shkak se me sjelljet dhe veprimet e tyre po pamundësojnë zhvillimin e punimeve të seancës plenare, vetëpërfshihen nga pjesëmarrja në seancën plenare, sot, më 14 dhjetor 2015.

Ndërsa deputetëve të grupeve parlamentare nga opozita: Besa Baftija, Ilir Dedaj, Time Kadrijaj, Rustem Berisha, Valdete Bajrami dhe Shukrije Bytyçi u lejohet pjesëmarrja në seancë plenare.

Në shenjë pakënaqësie me përfundimin e lartpërmendur, nënkryetarja e Kuvendit, Aida Dërguti, e lëshoi mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit dhe hodhi gaz lotsjellës në sallën C-301.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë në orën 12:55 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale